



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 814/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtaret Nenad Lazić kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Armend Shkoza, nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur për shkak të parregullsive dhe të mungesës së votave për zgjedhjet lokale të datës 03 Nëntorit 2013, në seancën e panelit të mbajtur me 12.11.2013, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET si e palejueshme ankesa e Armend Shkoza, nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV)

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 09.11.2013, nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në të cilën pretendon se me datën 08 nëntor 2013 në ora 19:00 nga anëtari i saj në KQZ Adnan Rustemi kanë pranuar raportin zyrtar të QNR-së për vendosjen e kutive në karantinë për hetim të mëtutjeshëm. Parashtruesi i ankesës thekson se në këtë raport janë të evidentuar mangësi për gjithsejtë 106 kuti të votimit për të dy palë zgjedhjet si ato për kuvende komunale ashtu edhe për kryetar komune. Nga këto 106 kuti të votimit që janë dërguar në karantinë me vendim të QNR-së LVV-ja parashtron ankesë për 84 kuti të votimeve, andaj me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se këto kuti të votimit mund të ndikojnë në rezultatin e zgjedhjeve për komunat përkatëse dhe poashtu mund të ndikojnë në besueshmërinë e rezultatit përfundimtar të procesit zgjedhor. Andaj me këtë rast parashtruesi i ankesës kërkon nga PZAP-i që të urdhëroj rivotim në të gjitha vendvotimet për këto kuti të votimit të karantinuara nga QNR-ja.

PZAP-i, shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e palejuar sepse me nenin 105.1 të LZP-së parashihet se: *“Ankesa lidhur me administrimin në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), dorëzohet me shkrim pranë PZAP-it brenda 24 orëve nga ndodhja e shkeljes së*


supozuar”. Sipas kësaj dispozite del se ankesa në PZAP nga palët e interesuar mund të parashtrohet për administrimin në QNR gjatë numërimit. Parashtruesi i ankesës më këtë rast nuk ka parashtruar ankesë për administrimin në QNR, por ankesa është e parashtruar për raportin e QNR-së dhe ndaj vendimit të QNR-së për shkak se 106 kutit QNR-ja ka vendosur ti dërgoj në karantinë. Më këtë rast PZAP-i vlerësoi se ankesa është e palejuar ngase me asnjë dispozitë ligjore të LZP-së nuk parashihet që të parashtrohet ankesë në PZAP ndaj raportit apo vendimeve të QNR-së për më tepër me nenin 122.1 të LZP-së përcaktohet se për çfarë vendime të KQZ-së ka të drejt PZAP-i, të merr vendime.

Andaj, bazuar në arsyet e sipërshënuar dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “PZAP-i, mund të hidh poshtë (si të palejuar, të parregullta apo të pa afatslihme) ankesat, të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3 të këtyre rregullave dhe procedurave, po ashtu PZAP refuzon ankesat të cilat janë të pabazuara, apo të cilat janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore”, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 814/2013 më datën 12.11.2013

**Kryesuesi i Panelit
Nenad Lazic**



Këshillë juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tyre do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.